



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Departamenti për Monitorim

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor - Shtator 2008

Leximi i deklaratave të dëshmitarëve në vend të marrjes në pyetje së vet dëshmitarëve në gjykim shkel ligjin vendor dhe të drejtën për gjykim korrekt

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) brengoset se në disa raste të monitoruara penale gjykatat kanë dështuar të sigurojnë prezencën e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në vend të kësaj lexon deklaratat të cilat i kanë dhënë ata paraprakisht gjatë hetimeve. Kjo shkel të drejtën e të pandehurit për gjykim të korrekt.

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për gjykim korrekt përmban të drejtën e të pandehurëve për të parashtruar pyetje dhe të pranoj pyetje nga dëshmitarët kundër tij.¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës vendos parim të përgjithshëm të ngjashëm.²

E drejta në gjykim korrekt “presupozon se të gjitha provat duhet normalisht të paraqiten në dëgjim publik, në praninë e të akuzuarit, në pikëpamje të argumenteve kundërshtuese.”³ Ngjashëm neni 368(1) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale parasheh si rregullë të përgjithshme se dëshmitarët duhet të merren në pyetje direkt apo nga gjykata. Kjo procedurë mund të zëvendësohet me leximin te deklaratave të dhëna paraprakisht në gjykatë, vetëm atherë kur ekzistojnë rrethanat e jashtëzakonshme (p.sh., kur dëshmitari ka vdekur apo është paaftësuar mentalisht, apo kur të gjitha pajtohen të zëvendësojnë parashtrimet e pyetjeve direkte me leximin e deklaratave).⁴

Sidoqoftë, OSBE-ja ka vëzhguar rastet kur deklaratat janë lexuar nga gjykata, edhe pse asnjëra nga rrethanat e parapara në nenin 368(1) ekzistonte.

Në një rast pranë gjykatës në regjionin e Prizrenit që përfshinte një të pandehur të akuzuar për sulm kundër personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare,⁵ në shqyrtimin kryesor të 25 janarit 2008, prokurori propozoi që të lexohen deklaratat e dy zyrtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës. Avokati mbrojtës kundërshtoi dhe kërkoi nga gjykata që të thërrasin dëshmitarët.⁶ Sidoqoftë, trupi gjykues vendosi të mos i ftojë

¹ Shih neni 6(3)(d), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

² Shih neni 10(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës , e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale”).

³ *Romanov kundër Rusisë*, 41461/02, vendimi, 24 korrik 2008, paragrafi 100. E drejta në gjykim të bazuar mbi kontradiktetin në parim nënkupton “mundësinë e palëve të kenë njohuri dhe të komentojnë në të gjitha provat e prezantuara ose vështrimet e ngritura me qëllim të ndikimit në vendimin e gjykatës.” (*L.B. Interfinanz A.G. kundër Kroacisë*, 29549/04, vendimi, 27 mars 2008, paragrafi 24).

⁴ Siaps Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëse “pamundësia” e marrjes në pyetje të dëshmitarëve rezulton vetem nga fakti se ata mungojnë, autoritetet duhet të bëjnë “përpjekje të arsyeshme” për sigurimin e prezencës së tyre (Shih *Bonev kundër Bullgarisë* 60018/00, vendimi, 8 qershor 2006, paragrafi 43).

⁵ Neni 317, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 qershor 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penal”).

⁶ Për më tepër, që nga pohimi i mbrojtës se atyre kurrë nuk u janë dhënë kopjet e deklaratave të dëshmitarëve, leximin e të cilave e kundërshtuan, nënkupton poashtu se avokatit nuk i është dhënë kohë apo lehtësime për përgatitjen e mbrojtjes, në shkelje të nenit 12 dhe 307 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, dhe të nenit 6(3)b të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

policët por t'i lexoj deklaratat e tyre.⁷ Me 30 janar 2008 gjykata e shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me tre muaj burgim.⁸

Ne rastin e sipërpërmendur, gjykata nuk ka bërë asnjë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e dëshmitarëve në gjykim. Për më tepër, e mohoi kërkesën e të pandehurit për të marr në pyetje dëshmitarin. Duke u mbështetur në deklaratat e tyre me shkrim, gjykata e privoi të pandehurin prej të drejtës së tij për t'i parashtuar pyetje dëshmitarët, në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁹

OSBE-ja poashtu ka monitoruar disa raste ku avokati mbrojtës është pajtuar të lexohen në gjykatë deklaratat e dëshmitarëve të prokurorisë, dhe kështu pavend i hoqën të drejtën e të pandehurve për të marr në pyetje dëshmitarët.

Në një rast pranë një gjykate në regjionin e Pejës, që përfshinte një të pandehur të akuzuar me posedim joligjor të armëve,¹⁰ dhe dëmtimin e monumenteve të mbrojtura¹¹ në seancën gjyqësore të 18 shtatorit 2008 kryetari i trupit gjykues i propozoi palëve ti lexojnë të gjitha deklaratat në dosjen hetimore. Ne mesin e tyre ishte edhe raporti i dëshmitarit ekspert e cila perfundoi se shenjat e gishtrinjëve të pandehurit përputheshin me ato të gjetura në armën e përdorur për kryerjen e krimit. Edhe pse dëshmitari do të mund të ftohej dhe të merrej në pyetje, avokati mbrojtës u pajtua që raporti të lexohej, kështu dështoi t'a sfidoj këtë provë kyqe. Për më tepër, avokati mbrojtës nuk ka ftuar asnjë dëshmitar për të pandehurin. Me 18 shtator 2008, i pandehuri është shpallur fajtor dhe u dënua me tri vjet dhe gjashtë muaj burgim.

Në rastin e sipërpërmendur si në rastet tjera të monitoruara, duke dhënë pajtimin për dëgjimin e procesverbaleve të deklaratave të dëshmitarëve në vend të dëshmimeve të drejtëpërdrejta të dëshmitarëve, avokati mbrojtës pengoi në mënyrë efektive të pandehurin për të marr në pyetje dëshmitarët kyq të prokurorisë. Është diskutabile nëse këto vendime përputhen me interesin e klientve të tyre.

Andaj, pozicioni i OSBE-së është se:

⁷ Provat e tilla janë të papranueshme, meqë mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia t'i "sfidojnë duke i marr në pyetje [këta] dëshmitarët gjatë fazave të ndryshme të procedurave penale" (Neni 156(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale). Është detyrë e gjykatës të "siguroj se asnjë provë e papranueshme [...] është përfshirë në dosje apo prezentuar në shqyrtimin kryesor" (Neni 154(5), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

⁸ Duke e mbështetur vendimin në një provë kjo është kushtimisht e papranueshme (shih fusnotën paraprake), gjykata shkeli jo vetëm ligjin vendor (neni 153(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale), por edhe të drejtën e të pandehurit në gjykim korrekt (sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, "denimi nuk duhet të mbështetet vetëm në apo në masë të konsiderueshme në deklarata të cilat mbrojtja nuk ka qenë në gjendje ti sfidoj." Shih *W kundër Finlandës*, 14151/02, vendimi, 24 prill 2007, paragrafi 43).

⁹ Shih *Barbera, Messegue and Jabardo kundër Spanjës*, vendimi, 6 dhjetor 1988, paragrafi 78.

¹⁰ Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (neni 328, Kodi i Përkohshëm Penal).

¹¹ Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Kosovës. (*id.*, neni 289).

- Gjykatat nuk duhet të lexojnë deklaratat e dëshmitarëve në vend të marrjese së tyre në pyetje përveq kur një apo disa përjashtime të parapara në nenin 368(1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale janë arritur.
- Avokatët duhet të kundërshtojnë propozimet për lexim të deklaratave të dëshmitarëve të prokurorisë atherë kur prezenca e tyre mund të sigurohet. Përpara se të pajtohen me leximin e deklaratave të dëshmitarëve, avokatët duhet të vlersojnë me kujdes nëse heqjen e drejtës së klientit për të marr në pyetje dëshmitarët të prokurorisë është në interesin më të mirë të klientit të tyre.

Shtyrja e shpeshtë e seancave për një periudhë të pacaktuar kohore në gjykatat e Kosovës kontribuon në grumbullimin e lëndëve gjyqësore dhe mund të shkel të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme

OSBE-ja është e brengosur se duke dështuar të caktoj një datë dhe kohë të veçantë për secilin dëgjim, gjykatat janë duke shkaktuar vonesa të panevojshme në procedurat civile, dhe kështu kontribuojnë në grumbullimin e lëndëve.

Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën për “dëgjim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme.” Një nga synimet e të drejtës në gjykim brenda kohës së arsyeshme është “të mbroj [palët] kundër procedurave të tej zgjatura” dhe të menjajoj situatën ku personi “duhet të qëndroj shumë gjatë në gjendje paqartësie lidhur me fatin e tij.”¹² Më përgjithësisht, e nënvizon “rëndësinë e ndarjës së drejtësisë pa vonesa që do të mund të rrezikonte efikasitetin dhe besueshmërin e saj.”¹³

Sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykatat kanë për detyrë të “gjykojnë dhe zhvillojnë procedurën pa asnjë vonese të panevojshme, duke shkaktuar sa më pak shpenzime që është e mundur dhe duke pamundësuar cdo keqpërdorim të drejtave që i përkasin palëve në procedurë.”¹⁴

Avokatët poashtu kanë rol të sigurojnë se rastet procedohen me efikasitet. Neni 50 i Kodit të Etikës Profesionale të Avokateve thotë, “Avokati duhet të kujdeset t’i ofroj palës së tij mbrojtje të nevojshme sapo të është e mundshme dhe me sa më pak shpenzime që është e mundshme, si dhe të luftoj çdo vonesë dhe shpërdorimin e drejtave para gjykatave dhe organeve tjera shtetërore.”¹⁵

Menaxhimi efektiv i lëndëve është mjet qenësor për menjanimin e vonesave të panevojshme në procedurat gjyqësore. Një mënyre e thjeshtë për sigurimin e lëvizjës efektive të lëndëve në procesin gjyqësor është duke caktuar datën dhe kohën e veçantë secilën seancë dëgjimore dhe të presin paraqitjen e sëcilës palë, përveq në rastet kur ata kanë arsytim të ligjshëm.

Sidoqoftë, OSBE-ja ka vërejt disa raste kur gjykatat kanë ricaktuar dëgjimet për datë të mëvonshme të pacaktuar.

¹² *H. Kundër Francës*, 10073/82 vendimi, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

¹³ *Stögmüller kundër Austrisë*, 1602/62, vendimi, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

¹⁴ Neni 10, Ligji i Procedurës Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës 4/1977, 36/1980, dhe 69/1982.

¹⁵ Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve, aprovuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, 11 qershor 2005.

Në fund të seancës për propozim të rigjyimit në regjionin e Mitrovicës në një rast të padisë për konfirmimin e pronësisë, gjykata e shtyu seancën për një kohë të pacaktuar. Rasti fillestar filloi me 17 maj 2003; i padituri ngriti propozimin për rigjykim me 4 Prill 2005. Gjykata përfundimisht e dëgjoi propozimin për rigjykim me 6 nëntor 2007. Eventualisht, gjykata e aprovoi kërkesën për rigjykim por kurrë nuk e caktoi datën për dëgjimin e parë. I padituri përfundimisht parashtroi ofertë për marrëveshje, por për momentin rasti ka ngecur për shkak të mos-funksionimit të gjykatës komunale të Mitrovicës.

Në një rast në regjionin e Prizrenit, paditësi ngriti padi për shkurorëzim me 6 nëntor 2003. Seanca e parë ishte caktuar në shtator 2005 por që shtyrë për kohë të pacaktuar meqë asnjëra palë nuk që paraqitur në gjykatë. Seanca e radhës u mbajt me 15 shkurt 2006 por u shtye për kohë të pacaktuar; arsye për shtyerje është e paqartë. Seanca pasuese ishte mbajtur 17 prill 2007. Seanca tjetër u mbajt me 14 dhjetor 2007 dhe prapë me 3 prill 2008. Në secilën seancë, gjykata mezi vërejtë prezencën e paditësit dhe mungesën e të paditurit. Asnjë çështje tjetër nuk u adresua.

Shpesh, gjykatat caktojnë raste për kohë të pacaktuar në mënyrë që të gjejnë vendndodhjen e të paditurit apo presin që agjencitë tjera të përgjigjen në kërkesën për ndihmë ligjore. Shpesh një shumë e konsiderushme e kohës kalon para se të mbahet dëgjimi i radhës.

Në një rast në regjionin e Pejës, që përfshinte anulimin/zhvleftësimin e kontratës, i padituri dështoi që të paraqitet në dëgjimin e 7 shtatorit 2006. Gjykata ju drejtua Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit të Drejtësisë, zyrës komunale për regjistrim civil me kërkesa të ndryshme për ndihmë ligjore. Në vend të ricaktimit të rastit për një kohë që do të mjaftonte për t'i mundësuar atyre të përgjigjen, gjykata caktoi dëgjimin e ardhshëm për një kohë të pacaktuar. Dëgjimi tjetër nuk u mbajt deri me 20 qershor 2008.

Në një rast pronësie në regjionin e Gjilanit, në nëntor 2006 gjykata ricaktoi dëgjimin për një kohë të pacaktuar në mënyrë që të gjejë vendndodhjen e të paditurin në mungesë. gjykata kërkoi nga Shërbimi Policor i Kosovës të shikoj për të paditurin dhe tha se rasti do të rivendoset atherë kur të marrin përgjigje. Dëgjimi i radhës u mbajt në mars të viti 2007.

Në rastet e sipërme, shtyrja për një kohë të pacaktuar çoi në vonesa të panevojshme në procedurë. Ricaktimi i rasteve për një kohë të pacaktuar poashtu gjeneron paqartësi: dëshmitarët nuk mund të ftohen për një datë të pacaktuar dhe palët ballafaqohen me veshtirësi për përgatitjen e gjykimit data e të cilit nuk dihet.

Nga ana tjetër, caktimi i datës së veçantë për dëgjimin e radhës i mundëson gjykatave të informojnë dëshmitarët e propozuar për kohën kur pritet që ata të japin dëshminë, i siguron që palët dhe gjykata të mund të përgatiten më mirë për seancën, dhe i motivon

palët të dorëzojnë prova gjëgjese në kohë. Për më tepër, i mundëson gjykatave të caktojnë më mirë të gjitha rastet që i dëgjojnë.

Për atë që u tha më lartë, qëndrimi i OSBE-së është se:

- Në fund të çdo seance, gjykatat duhet të caktojnë datë të veçantë për seancën e rradhës.
- Avokatët duhet të kërkojnë nga gjykatat të caktojnë datë të veçantë kur seanca e rradhës do të mbahet. Në qoftë se rasti është shtyrë për kohë të pacaktuar, avokatët duhet të vlersojnë rregullisht nëse ekzistojnë kushtet për mbajtjen e seancës dëgjimore.